



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 20
Prishtinë, më 12.04.2018, në orën 15:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Znj. Vjosa Osmani-Sadriu, Znj. Time Kadrijaj, Z. Danush Ademi, Znj. Aida Dërguti, Z. Visar Ymeri, Z. Dukagjin Gorani, Z. Elmi Reçica, Znj. Evgjëni Thaçi-Drăgusha, Z. Sërgjan Mitrovic dhe Z. Zafir Berisha.

Mungoi: Znj. Doruntinë Maloku-Kastrati.

Delegacioni nga Kuvajti ishte në përbërje: Z. Waleed Al Tabtabae, kryetar i Grupit parlamentar të miqësisë Kuvajt-Kosovë, Z. Muhammad Al Mutairi, anëtar i Grupit, Z. Husain Alabdeen, zyrtar i Grupit të Miqësisë dhe Z. Munir Albaqshi, drejtor i marrëdhënjeve me jashtë.

Nga zyra e komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

Takim i Komisionit me Grupin Parlamentar të Miqësisë Kuvajt-Kosovë

Vjosa Osmani-Sadriu fillimisht falënderoi delegacionin e Grupit të miqësisë Kuvajt-Kosovë, për vizitën në Kosovë dhe i prezantoi anëtarët e Komisionit. Ajo theksoi se në mes të Kosovës dhe Kuvajtit ka pasur vizita bilaterale, të cilat shpreson se do të vazhdojnë edhe më tej në mënyrë që të zhvillohet bashkëpunimi i dyanshëm në mes të dy vendeve. Falënderoi delegacionin për kontributin që ka dhënë shteti i të Kuvajtit në përkrahjen e Kosovës, e në veçanti në kontestin multilateral. Prioritet i politikës sonë të jashtme tha se tani është fuqizimi i shtetësisë së Republikës së Kosovës. Gjatë kësaj vizite tha se delegacioni i grupit të miqësisë nga Kuvajti do ta ketë mundësinë që të takohet edhe me ministrinë përkatëse të cilat merren me zhvillimin ekonomik në mënyrë që të diskutohen mundësitë e bashkëpunimit ekonomik, potencialet e investimit në Kosovë, si dhe mundësitë e bashkëpunimit edhe në fusha të tjera.

Waleed Al-Tabtabae shprehu fjalë miradije për Kosovën dhe popullin e saj, për të cilën tha se e ka arritur pavarësinë me përpjekje maksimale dhe se një pjesë e madhe e shteteve të botës qëndruan

pranë saj. Z. Al-Tabtabae theksoi se ka dëshirë për të përkrahur shtetin e Kosovës që të ecë drejtë prosperitetit dhe zhvillimit. Njoftoi se nga Kosova kanë pasur vizita në shtetin e Kuvajtit. Ai informoi për gatishmërinë e shtetit të Kuvajtit që të ndihmojë në zhvillimin e infrastrukturës së shtetit të Kosovës, në rrugë, aeroporte, metro dhe çdo gjë që ndihmon ekonominë e Kosovës. Për këtë tha se na nevojiten disa studime të mirëfillta fizibiliteti, në mënyrë që të thithen investimet kuvajtiane dhe njëkohësisht ndihmat e shtetit të Kuvajtit. Z. Altabtabae njëkohësisht njoftoi për mundësinë e bashkëpunimit në këmbimin e eksperiencave në mes të dy vendeve, në sferën e bujqësisë. Theksoi gatishmërinë për bashkëpunimin në mes të dy parlamenteve dhe për të ndikuar në shtetet arabe, të cilat deri më tani nuk kanë arritur ta njohin shtetin e Kosovës.

Vjosa Osmani-Sadriu theksoi se zhvillimi i raporteve ndërparlamentare në mes të dy shteteve mund të jetë një hap i mirë i cili do të ndihmojë edhe më tej raportet në mes të dy vendeve tona. Ajo njoftoi se ky komision mbulon edhe çështjen e njohjeve dhe përmes realizimit të vizitave dypalëshe janë duke bërë përpjekje të krijojnë raporte edhe me shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën. Theksoi se shpreson në ndihmën e Kuvajtit që të ndikojë tek shtetet e Ligës Arabe, por edhe te shtetet tjera të Organizatës së Bashkëpunimit Islamik që ta njohin Kosovën, meqë mbi 20 shtete nga kjo organizatë nuk e kanë njohur ende. Shpresojmë tha ajo që me ndihmën e Kuvajtit do të krijojmë kontakte me parlamentet e shteteve të tjera të ligës arabe në mënyrë që edhe atje të dëgjohet zëri i Kosovës dhe krijohet mundësia e bashkëpunimit.

Time Kadrijaj në diskutimin e saj theksoi se Kuvajtin e konsiderojmë vend mik dhe përkrahës të popullit të Kosovës dhe pavarësisë së saj. Respekti i juaj ndaj Kosovës tha se është i ndërsjellë dhe të njëjtin e ka populli i Kosovës për popullin tuaj. Kosova tha se është një shtet i ri, i cili ka ngecje sa i përket njohjes së pavarësisë së saj, por edhe për të qenë pjesë e organizatave të ndryshme ndërkombëtare. Në këtë drejtim theksoi se ka shtete të cilat po llojnë edhe në ato shtete që e kanë njohur pavarësinë tonë, për ta dëmtuar imazhin e Kosovës. Theksoi se do të ishim mirënjohës për angazhimin e Kuvajtit që të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në lobim për njohjen e saj dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare. Znj. Kadrijaj njëkohësisht theksoi nevojën për bashkëpunim parlamentar në mes të dy vendeve dhe për këmbimin e përvojave.

Visar Ymeri tha se i bashkëngjitet diskutimeve të anëtarëve të Komisionit për falënderimet në bashkëpunimin dhe mbështetjen e Kuvajtit, ndaj shtetit të Kosovës. Theksoi se kjo është e hera e parë që Kosova e ka një shtet të vetin, i cili deri diku i afrohet vullnetit politik që ka pasur populli ynë dhe që e ka shprehur për një kohë të gjatë, por liria e shtetit nuk mund të jetë e plotë nëse nuk përcillet edhe me mirëqenie dhe zhvillim ekonomik. Si probleme madhore të shtetit të Kosovës tha se janë konkretizimi i sovranitetit tonë, si në aspektin e njohjeve, anëtarësimin në organizata ndërkombëtare si dhe çështja e zhvillimit të brendshëm. Aspekti i zhvillimit të brendshëm ekonomik tha se është shumë i nevojshëm për Kosovën për ngritjen e mirëqenies së saj dhe ndaljen e zbrazjes së qytetarëve tanë, si tendencë e vazhdueshme në Kosovë. Z. Ymeri theksoi se në Kosovë pos investimeve në fusha të caktuara që janë të nevojshme, kemi nevojë edhe për zhvillimin e marrëdhënieve tregtare me vendet e tjera.

Elmi Reçica delegacionin nga Kuvajti e njoftoi se opinioni i qytetarëve tanë për shtetin e Kuvajtit është shumë pozitiv dhe u është falënderues për çdo gjë që kanë bërë për shtetin dhe qytetarët e Kosovës. Z. Reçica pajtohet me diskutimet e anëtarëve të komisionit se Kosova ka nevojë për mbështetje për njohje të reja, por njëkohësisht ka nevojë të mbështetet edhe lidhur me ofensivën e Serbisë për tërheqjen e njohjeve. Z. Reçica duke cilësuar të nevojshme diskutimet për diplomacinë parlamentare, investimeve të mundshme në cilësi të anëtarit të komisionit për anëtarësimin e Kosovës

në Interpol, kërkoi mbështetjen e shtetit të Kuvajtit për anëtarësim të Kosovës në këtë organizatë, duke bërë të ditur se shteti i Kosovës edhe zyrtarisht do të kërkojë mbështetjen në këtë drejtim.

Zafir Berisha tha se e rëndësishme është rritja e bashkëpunimit dhe fuqizimit në mes të dy shteteve, si në fushën politike, ashtu edhe në atë ekonomike. Ajo që do ta ndihmonte Kosovën tha se do të ishte mundësia e krijimit të një ambienti për lobim përmes Kuvajtit. Çështje thelbësore e cilësoi fuqizimin e ekonomisë së vendit dhe krijimin e mundësisë për lëvizje të lirë, pa viza, të qytetarëve të Kosovës në Kuvajt pasi që kjo do të krijonte hapësirë që qytetarët dhe bizneset e vendeve tona të lidhën drejtpërdrejt.

Dukagjin Gorani tha se Kuvajti është një vend i fuqishëm, është një vend me ndikim, kurse Kosova është një shtet i ri dhe i varfër. Serbia në Lindjen e Mesme dhe Gadishullin Arabik dhe përgjatë Emirateve të Bashkuara përpiqet të flasë në emër të një federate që nuk ekziston, duke u thirrur në marrëdhëniet e dikurshme të mira të asaj federate dhe duke e paraqitur vetën si trashëgimtare të Jugosllavisë, shtoi z. Gorani. Ai po ashtu tha se pasuria e vetme e shtetit të Kosovës janë njerëzit, Kosova nuk është vend i resurseve të mëdha, por është vend i një shoqërie e cila ka entuziazëm të madh për punë, zhvillim, bashkëpunim, shkëmbim, si dhe për përvoja, meqenëse është vend i cili mbahet i izoluar padrejtësisht. Ndhimesë të madhe për Kosovën tha se do të ishte përkrahja e Kuvajtit në kuptimin e drejtë të historisë sonë. Kosova tha se mbetet e hapur që të krijojë miq, meqenëse përtej njerëzve dhe miqësisë pak ka çfarë të afrojë. Z. Gorani theksoi se vizita e delegacionit të Kuvajtit për ne është një shpresë për miqësi, bashkëpunim, por edhe përkrahje.

Danush Ademi tha se Kuvajti i ka ndihmuar Kosovës në shumë sfera, por Kosova ka nevojë për ndihmë edhe më tutje. Ai njoftoi se është përfaqësues i komunitetit ashkali në Kuvend, një popull i varfër ekonomikisht. Z. Ademi tha se Parlamenti i Kosovës është ndoshta parlamenti më i veçantë i Evropës sepse në të janë të përfaqësuara të gjitha komunitetet e Kosovës. Kërkoi nga shteti i Kuvajtit që të bëjë më shumë për Kosovën, sepse Kosova ka nevojë për ndihmën e tyre.

Mohammed Al - Mutairi, në fjalën e tij theksoi se Kosovën e konsiderojnë si pjesë të tyre, pjesë të botës arabe dhe islame, dhe se Kosova ka histori të gjatë dhe të veçantë. Kosova tha se ka pasuri të mëdha natyrore, si dhe ka potenciale shumë të mëdha për turizëm ose investime, por ka nevojë për një marketing më të mirë për këto potenciale. Ai foli për dijetarin shqiptar të fushës fetare Nastradin Albani, i cili ka jetuar në Damask dhe i cili ka lënë trashëgimi shumë të madhe kulturore me shumë dorëshkrime dhe botime të ndryshme. Shprehu dëshirën për ta zhvilluar bashkëpunimin në nivelin e dy parlamenteve dhe se do të bëjnë maksimumin që bota arabe dhe islame ta kenë njohjen e plotë për shtetin e Kosovës, duke shtuar se Kosova duhet ta bëjë marketingun e duhur që ato vende ta njohin realitetin e Kosovës dhe historinë e saj. Z. Al-Mutairi tha se e ka ndjekur historikun e Kosovës prej shumë vitesh, para dhe gjatë luftës dhe sidomos shpalljen e pavarësisë së saj dhe se Kuvajti ka dërguar institucione jo fitimprurëse në Kosovë të cilat kanë dhënë ndihmën e tyre fillestare pas çlirimit. Rëndësi të veçantë tha se do të kishte vizita e Ministrit të Jashtëm të Kosovës në të gjitha vendet arabe dhe njëkohësisht mundësia e pjesëmarrjes në Organizatën Islamike, ku marrin pjesë 27 shtete myslimane në mënyrë që të dëgjohet fjala e tij për njohjen e Kosovës.

Waleed Al Tabtabae shprehu mendimin se duhet një koordinim më i mirë në mes të dy vendeve në mënyrë që të arrihet anëtarësimi i Kosovës në Interpol dhe UNESCO. Kërkoi nga Kosova ta shqyrtojë mundësinë e anëtarësimit në Organizatën e Bashkëpunimit Islamik, në të cilën tha se bëjnë pjesë 57 shtete ku anëtare e saj është edhe Republika e Shqipërisë. Sa i përket njohjes së Kosovës nga shtetet arabe, tha se do të punojë në drejtim të njohjes së Kosovës nga shtetet si Maroku, Libia dhe Bahrejini,

pasi si anëtar i Parlamentit arab ka miqësi me deputetët e këtyre vendeve. Sa i përket heqjes së vizave për popullin e Kosovës tha se do të flasin me Qeverinë e tyre në mënyrë që të arrihet diçka pozitive në këtë drejtim. Lidhur me investimet z. Al-Tabtabae shprehu dëshirën e krijimit të një porti të ri, i cili do të bëhej me ndihmën e fondeve të shtetit të Kuvajtit, në pikën më të afërt të detit të tokave shqiptare, si një port i veçantë për Republikën e Kosovës. Përpyekjet e Serbisë për t'i tërhequr njohjet e disa shteteve tha se mbështeten nga Rusia, ku shtetet si Egjipti, Libani, Algjeria janë shtete që kanë marrëdhënie shumë të mira me Rusinë, e cila ndikon për mos njohjen e këtyre shteteve të Republikës së Kosovës. Ai po ashtu foli edhe për luftën që është duke u zhvilluar në Siri, ku për shkak të Rusisë dhe Iranit po ndodhim shumë probleme në atë pjesë sepse ata bëjnë luftë të padrejtë duke e përkrahur sistemin e Assadit, i cili vret dhe shkatërron popullin nëpërmjet armëve kimike në masë. Në fund z. Al-Tabtabae shtoi se do të japin maksimumin për ta arritur njohjen Republikës së Kosovës.

Vjosa Osmani-Sadriu falënderoi delegacionin për gatishmërinë e tyre dhe të shtetit të tyre për avancimin e raporteve. Ajo tha se do të mbetemi në kontakt me ju dhe ambasadën tuaj në Shqipëri në mënyrë që të koordinohemi sa i përket aplikimit të Kosovës për anëtarësim në Interpol, pastaj edhe në UNESCO. Serbia tha se po bënë një fushatë të tmerrshme kundër Kosovës të bazuar në dokumente të falsifikuara sa i përket anëtarësimit në UNESCO, duke u ankuar se nuk ka siguri të kishave gjë që nuk është e vërtetë për Kosovën. Osmani Sadriu shtoi se Serbia është fajtorë e drejtpërdrejtë jo vetëm për politikën gjenocide në raport me Kosovën, por edhe me shkatërrim masiv të trashëgimisë kulturore në Kosovë gjatë luftës së fundit, duke përfshirë rreth 500 xhami për të cilat është dokumentuar se janë shkatërruar tërësisht apo pjesërisht nga ana e Serbisë gjatë luftës së fundit. Sa i përket njohjeve, ajo njoftoi se Bahrejni është shtet që e ka njohur Kosovën, dhe do të vlerësohej shumë ndihma e Kuvajtit që raportet e Kosovës me shtetet tjera të avancohen. Maroku dhe Libia tha se janë shtete për të cilat kemi nevojë të na ndihmoni që së paku ta bëjmë hapin e parë të krijimit të raporteve. Ajo tha se ne do të angazhohemi për ta fuqizuar shtetin e Kosovës dhe shpresojmë në ndihmen tuaj kryesisht në ato vende ku ne nuk mund të arrijmë.

Në mes të delegacioneve, në fund të takimit u shkëmbyen dhurata simbolike.

Mbledhja përfundoi në orën 16:10.

Kryetarja e komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.